



KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

Nr. 384-01/2025

Data: 15.12.2025

БУЈАНОС

Në bazë Nenit 113 paragrafi 2 pika 1 të Ligjit për Këshillat Kombëtare të Pakicave Kombëtare (Fletorja zyrtare R.S. 72/2009,20/2014 - vendimi i GJK 55/2014 dhe 47/2018) dhe neni 14, paragrafi 1, pika 3 dhe 20 e Statutit të Këshillit të Kombëtar Shqiptar nr.284-01/23 të datës 06.07.2023, si dhe Vendimit të Këshillit Kombëtar Shqiptar nr. 364-01 datë: 08.12.2025 shpallim:

**THIRRJE PUBLIKE PËR MBËSHTTJE TË PROJEKT PROPOZIMEVE NGA
ORGANIZATAT QË KANË NË FOKUS AVANCIMIN DHE SOCIALIZIMIN E
FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË LUGINËN E PRESHEVËS**

QËLLIMI I THIRRJES

Qëllimi i kësaj thirrjeje është të mbështesë projektet që kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin, përfshirjen dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe nxënësve shqiptarë me nevoja të veçanta në komunat e Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës. Puna me këtë kategori fëmijësh është pjesë thelbësore e politikave të Këshillit Kombëtar Shqiptar për barazi, gjithëpërfshirje dhe mbrojtje të të drejtave të komunitetit shqiptar në Serbi, ndaj përmes kësaj thirrjeje synohet mbështetja e programeve që fuqizojnë zhvillimin e tyre arsimor, social dhe emocional.

Përmes aktiviteteve edukative, rehabilituese, psikologjike, kulturore dhe sociale, projekti duhet të krijojë kushte më të mira për pjesëmarrje aktive të fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet arsimore dhe në jetën e përditshme të komunitetit. Thirrja synon të nxisë krijimin e programeve që lehtësojnë qasjen në shërbime mbështetëse, ngritin aftësitë e stafit profesional, krijojnë hapësira të sigurta dhe të përshtatshme për zhvillimin e tyre, si dhe ofrojnë mundësi për integrim të plotë dhe dinjitoz.

Përkrahur nga Qeveria e Republikës së Kosovës





KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

Një objektiv i rëndësishëm i kësaj thirrjeje është edhe forcimi i identitetit kombëtar, përmes aktiviteteve që ruajnë dhe promovojnë gjuhën, kulturën dhe traditat shqiptare, duke i bërë ata pjesë të proceseve të rëndësishme komunitare.

Kjo thirrje bazohet në Ligjin Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2025, nga organizata buxhetore “Zyra e Kryeministrit”, nën-programi “Përkrahje për Luginën e Preshevës dhe Sanxhakun” me kod 3910, dhe zbatohet nga Këshilli Kombëtar Shqiptar.

Shuma e përgjithshme e fondeve që do të ndahen përmes kësaj thirrjeje përcaktohet me vendim të veçantë të Këshillit Kombëtar Shqiptar, në varësi të kapaciteteve financiare dhe prioriteteve strategjike për vitin 2025. Qëllimi është që përmes një procesi transparent dhe profesional të përzgjidhen projektet më të qëndrueshme, më të nevojshme dhe me ndikimin më të madh në komunitet.

Shuma maksimale për një përfitues është 30.000 Euro, e në shumën maksimale të kërkuar aplikuesi obligohet të angazhoj së paku 5 asistentë për 5 muaj, duke kapur të plotë gjysëmvetorin e dytë të vitit shkollor 2025/2026. Ndërsa pagesa për një asistent të angazhuar nuk mund të jetë nën 50.000 dinarë (bruto)

APLIKIMI

Të drejtë aplikimi kanë organizatat dhe shoqatat e shoqërisë civile të cilat janë të regjistruara në regjistrin përkatës dhe veprojnë në mënyrë të rregullt ligjore në territorin e Luginës së Preshevës. Organizatat duhet që në aktet e tyre themeluese të kenë të përcaktuar qartë veprimtarinë në fushën e punës me fëmijë dhe nxënës me nevoja të veçanta në institucionet parashkollore dhe shkollat fillore, si dhe të kenë demonstrim të vazhdueshëm të kësaj veprimtarie në aktivitetet e tyre shumëvjeçare.

Aplikimi është i paraparë vetëm për organizatat që e kanë selinë brenda komunave të Preshevës, Bujanocit ose Medvegjës, duke siguruar kështu që projektet të jenë të lidhura ngushtë me nevojat reale të komunitetit shqiptar lokal dhe të fëmijëve që përfshihen në këtë kategori.

Përkrahur nga Qeveria e Republikës së Kosovës





KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR
НАЦИОНАЛНИ САБЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

Organizata duhet të ketë minimalisht pesë vite përvojë të dokumentuar në punën me fëmijë me nevoja të veçanta, për të garantuar cilësinë, profesionalizmin dhe aftësinë e tyre për të menaxhuar një projekt vjetor.

Organizatat që aplikojnë për angazhimin e asistentëve duhet të jenë të themeluara dhe me përvojë minimale prej 5 vitesh në fushën e implementimit të projekteve me fokus në socializimin dhe avancimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Ndërsa organizatat që aplikojnë me projekt-propozime që në fokus kanë implementimin e projekteve që kanë fokus socializimin, trajtimin apo ndihmën në forma të tjera drejtë avancimit të fëmijëve me nevoja të veçanta, kërkohet të kenë përvojë 3 vite me realizimin e projekteve të ngjashme.

Çdo organizatë ka të drejtë të aplikojë vetëm me një projekt..

KRITERET E VLERËSIMIT TË PROJEKTEVE

Vlerësimi i projekteve do të bëhet nga një komision i pavarur, në përputhje me kriteret e përcaktuara më poshtë. Çdo projekt do të analizojë nivelin e përputhjes me objektivat e thirrjes, qartësinë e planifikimit dhe kapacitetin e organizatës për të realizuar aktivitete të qëndrueshme dhe me ndikim real.

- **Përputhja me qëllimin e thirrjes.** Projekti duhet t'i përgjigjet drejtpërdrejt nevojave të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe të kontribuojë në zhvillimin, përfshirjen dhe mirëqenien e tyre, dhe asistimin e tyre në pjesmarrje aktive në ndjekjen e mësimnxënies në shkollat fillore ose në sistemin parashkollor.

- **Kohëzgjatja e projektit.** Programi duhet të planifikohet me aktivitete të qarta, të realizueshme dhe të shpërndara në mënyrë të balancuar përgjatë gjithë vitit.

- **Qëndrueshmëria dhe vazhdimësia.** Komisioni do të vlerësojë potencialin e projektit për të vazhduar edhe pas përfundimit të financimit, duke parë aftësinë e organizatës për të krijuar struktura dhe modele pune të qëndrueshme.

- **Qartësia e grupit target.** Duhet të përcaktohen në mënyrë të saktë fëmijët dhe nxënësit që

Përkrahur nga Qeveria e Republikës së Kosovës





KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

përfshihen, karakteristikat e tyre dhe mënyra se si projekti u përgjigjet nevojave të tyre specifike.

- **Kapacitetet profesionale dhe administrative.** Vlerësohet përvoja e ekipit, aftësia menaxhuese, struktura organizative dhe praktikat e mëparshme të implementimit të projekteve të ngjashme. Tek asistentët përparësi të kenë të licencuarit dhe të interesuarit për të punuar me fëmijët me nevoja të veçanta.

- **Arsyetimi i buxhetit.** Buxheti duhet të jetë i qartë, i argumentuar dhe proporcional me aktivitetet e propozuara, duke shmangur shpenzimet e panevojshme.

Kriteret shtesë të domosdoshme

• **Zhvillimi i aktivitetit në territorin e Luginës së Preshevës.** Projekti duhet të zbatohet ekskluzivisht në Preshevë, Bujanoc ose Medvegjë.

• **Përvoja e organizatës.** Organizatat që aplikojnë për angazhimin e asistentëve duhet të jenë të themeluara dhe me përvojë minimale prej 5 vitesh në fushën e implementimit të projekteve me fokus në socializimin dhe avancimin e fëmijëve me nevoja të veçanta.

Ndërsa organizatat që aplikojnë me projekt-propozime që në fokus kanë implementimin e projekteve e që lidhen me socializimin, trajtimin apo ndihmën në forma të tjera drejtë avancimit të fëmijëve me nevoja të veçanta, kërkohet të kenë minimum 3 vite përvojë me realizimin e projekteve të ngjashme.

DOKUMENTACIONI I KËRKUAR

Të gjithë aplikuesit duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm për të qenë të pranueshëm:

Formulari i plotësuar i aplikimit

Projekt-propozimi i detajuar (përshkrim, objektiva, aktivitete, kohëzgjatje)

Buxheti i detajuar i projektit

Certifikata e regjistrimit të organizatës (originali ose kopje e noterizuar);

Përkrahur nga Qeveria e Republikës së Kosovës





KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

Statuti i organizatës (origjinali ose kopje e noterizuar);

CV e drejtuesit dhe e të gjithë anëtarëve të ekipit të paraparë në projekt;

Raport mbi aktivitetet e realizuara (nëse ka);

Deklaratë për përputhshmëri me kriteret e thirrjes;

Dëshmi për projekte të mëparshme të realizuara (nëse ka) ;

Letër mbështetjeje nga partnerë lokalë (nëse aplikohet në emër të një bashkëpunimi);

Deklaratë se të dhënat janë të sakta.

VËREJTJE

1: Organizatat apo individët të cilët kanë qenë përfitues të granteve në vitet e mëherëshme, e të cilët nuk kanë dorëzuar pranë KKSH Rapo

rte të rregullta sipas kontratës, sikurse organizatat që kanë përfituar nga Buxheti i Republikës së Kosovës përmes Ministrive gjatë këtij viti (2025), do të eliminohen nga Konkursi!

2: Organizatat e themeluara pas shpalljes së konkursit (thirrjes) nuk do të shqyrtohen;

4. Kufizimi i lidhjes familjare: vetëm 1 aplikues (përfaqësues ligjor) nga lidhja ngushtë familjare(bashkëshort-bashkëshorte, prind-fëmij dhe aplikues-prind) mes aplikuesve do të pranohet për në fazën e vlerësimit të aplikimit (në rast se paraqiten raste të tilla, përparësi do të ketë aplikuesi i cili ka aplikuar i pari).

Poashtu nuk do shqyrtohen projekt propozimet e aplikuesit (përfaqësuesit ligjor) i cili ka lidhje të ngushtë familjare me anëtarin e Këshillit Kombëtar Shqiptar (bashkëshort/e, fëmijët dhe prindërit e anëtarit të KKSh) meqë llogariten si konflikt interesi.

Përkrahur nga Qeveria e Republikës së Kosovës





KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

5. Të drejtë aplikimi kanë organizatat të cilat kanë selitë e tyre në Preshevë, Bujanoc, Medvegjë dhe me themelues shqiptar (të jenë të deklaruar si shqiptar në listën e veçant zgjedhore për këshillat kombëtar)

6. Organizatat të cilat janë përfituese nga konkursët paraprakë të këtij viti të shpallura nga KKSh përmes të njejtës vijë buxhetore nga Buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nuk kanë të drejtë të aplikojnë. Prandaj në rast aplikim, ato projekte nuk do të shqyrtohen nga Komisioni Vlerësues

PROCESI I ZBATIMIT TË THIRRJE

- a. **Shpallja e thirrjes publike:** Thirrja publikohet në faqet zyrtare të KKSh dhe rrjetet sociale dhe mediat lokale. Aplikimi do të jetë i hapur për 8 ditë nga dita e publikimit.
- b. **Pranimi i aplikimeve:** Aplikimet duhet të dorëzohen fizikisht në selinë e Këshillit Kombëtar Shqiptar apo në njërën nga zyrat në Preshevë, Medvegjë më së voni 22.12.2025 në ora 15:00. Secilit aplikim do t'i jepet një numër protokolli.
- c. **Verifikimi administrativ:** Staf i administrativ do të verifikojë plotësinë e dokumentacionit. Aplikimet me dokumentacionin e kërkuar të paplotë, do të refuzohen.
- d. **Vlerësimi profesional:** Komisioni i pavarur do të vlerësojë çdo projekt sipas kriterëve të përcaktuara.
- e. **Përzgjedhja dhe publikimi i përfituesve:** Lista përfundimtare e përfituesve do të publikohet në mënyrë transparente dhe do të njoftohen edhe në mënyrë individuale.
- f. **Nënshkrimi i marrëveshjeve:** Me përfituesit do të nënshkruhen kontrata që përcakton detyrimet, afatet dhe mënyrën e zbatimit të projektit.

Përkrahur nga Qeveria e Republikës së Kosovës





KËSHILLI KOMBËTAR SHQIPTAR
НАЦИОНАЛНИ САВЕТ АЛБАНСКЕ НАЦИОНАЛНЕ МАЊИНЕ
NATIONAL COUNCIL OF ALBANIAN NATIONAL MINORITY

g. Zbatimi dhe monitorimi i projekteve: Përfituesit do të kenë detyrimin të dorëzojnë raporte narrative dhe financiare. Aktivitetet do të monitorohen nga një ekip i dedikuar nga KKSh për të siguruar transparencë dhe efektshmëri.

e. Raporti final.

Secili përfitues i projektit obligohet të dorëzojë raportin final narrativ dhe financiar me dëshmi të realizimit të projektit.

Format për aplikim si dhe të gjitha informatat tjera gjinden në www.kksh.org (website i KKSH-së). Për informata shtesë ju lutem na shkruani në kksh.grantet@gmail.com ose na telefononi në nr. 00 381 17 853 264.

Vërejtje: Vetëm aplikimet e dorëzuara brenda afatit dhe me dosje të plotë do të shqyrtohen.

Përkrahur nga Qeveria e Republikës së Kosovës

